



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 4-40/2018 regjistër (JR)
Datë 01.02.2023

Nr. 61 i vendimit
Datë 24.03.2026

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.03.2026, ditën e martë, në orën 12:15, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen që i përket:

KËRKUES: Arben Dollapaj, lindur më {***} dhe banues në adresën, rruga “{***}”, {***}, nr. {***}, Tiranë, përfaqësuar¹ nga avokat Viktor Gumi me nr. licence {***}.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 4, datë 12.03.2020.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dhe neni 494 i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkesit në kërkesat e paraqitura prej tij, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 4 (JR), datë 12.03.2020, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

¹ Me prokurën e posaçme nr. {***} rep., dhe nr. Kol. {***}, datë 31.01.2023.

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Arben Dollapaj (në vijim “kërkuesi”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Fillimisht kaloi fazën e hetimit dhe shqyrtimit administrativ pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), i cili me vendimin nr. 63, datë 06.08.2018, vendosi *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj*. Ky vendim është ankuar nga Komisioneri Publik, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”).
2. Pasi ka shqyrtuar ankimin e Komisionerit Publik, trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin nr. 4 (JR), datë 12.03.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 63, datë 06.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, prokuror në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në momentin e shpalljes së këtij vendimi*.
3. Kërkuesi ka paraqitur në Kolegj dy kërkesa për rishikimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

3.1. Kërkuesi ka dorëzuar më datë 01.02.2023 kërkesën për rishikim të vendimit nr. 4 (JR), datë 12.03.2020, regjistruar në Kolegj si çështja me nr. 4-40/2018 (JR), nëpërmjet së cilës sjell në vëmendje se më datë 04.10.2022, GjEDNJ-ja ka dhënë vendimin për çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, për të cilën ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me të drejtën e kërkuesit (Besnik Cani) për një “*gjykatë të krijuar me ligj*”. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare ka një vend të posaçëm. Në nenin 116 të Kushtetutës, që i rendit marrëveshjet ndërkombëtare direkt pas Kushtetutës, u jep atyre fuqi mbiligjore në sistemin e burimeve normative. Sa më sipër, rezulton e qartë pozita e favorshme që kanë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 6/2006 ka përcaktuar se baza ligjore mbi të cilën ngrihet një kërkesë e tillë, ka të bëjë drejtpërdrejt me konceptin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është i rëndësishëm, jo vetëm se sqaron vendin e KEDNJ-së në të drejtën e brendshme, por trajton në mënyrë shteruese edhe disa aspekte në lidhje me të.

3.2. Kërkuesi shpjegon se më i qartë është qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 20/2011, kur kjo gjykatë nuk i është referuar Konventës si akt dhe pozicionit të saj në rendin e brendshëm juridik, po është ndalur më tepër në aspektin e efekteve juridike të vendimeve të GjEDNJ-së. Kërkuesi sqaron se vendimi i GjEDNJ-së i çështjes *Besnik Cani kundër Shqipërisë* ka marrë formë të prerë dhe është bërë përfundimtar në datën 04.01.2023, ndaj brenda afatit 30-ditor paraqitet kjo kërkesë për rishikim vendimi gjyqësor. Kërkuesi Arben Dollapaj pretendon se kërkesa për rishikimin e vendimit nr. 4, datë 12.03.2020, i paraqitet Kolegjit,

sepse vendimi për rivlerësimin në ngarkim të tij është dhënë nga Kolegji, i cili e ka shqyrtuar çështjen në themel, sipas së drejtës së brendshme.

3.3. Përsëri në kërkesën e tij, kërkuesi pretendon se përveçse në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, z. L. D. ka qenë relator i çështjes së tij të rivlerësimit. Duke qenë palë e interesuar dhe duke pasur interes të ligjshëm për të paraqitur kërkesën për rishikim, sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, pasi është gjykuar dhe shkarkuar nga një gjyqtar i emëruar në detyrë në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj-së. Kjo formë rishikimi çon në një përjashtim që lind për shkak të kërkesës për të respektuar detyrimet që burojnë nga e drejta ndërkombëtare. Në këtë kontekst, gjykata rishikuese, në rastin konkret Gjykata Kushtetuese, duhet të vlerësojë se si shkaqet e parregullsisë së procesit të mëparshëm të konstatuar nga GjEDNj-ja përkthehen në gabime të veprimeve procedurale të parashikuara nga legjislacioni kombëtar e, për rrjedhojë, duhen marrë të gjitha masat e duhura që këto gabime apo parregullsi të mos ndodhin në procesin e ri gjyqësor.

3.4. Kërkuesi sqaron se në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, GjEDNjja i është referuar parimeve të vendosura nga Dhoma e Madhe në gjykimin e çështjes *Ástráðsson kundër Islandës* dhe testit të tre fazave të përcaktuara në të. Islanda në zbatim të këtij vendimi të Dhomës së Madhe ka ndërmarrë rishikimin e të gjithë vendimeve gjyqësore, në të cilat anëtari i trupës gjykuese ishte emëruar në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në funksionin e tij për të mbikëqyrur zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së në të drejtën e brendshme, konstatoi se rihapja e proceseve gjyqësore për ata individë që ishin gjykuar nga anëtarë të trupës gjykuese të emëruar në kundërshtim me nenin 6 të Konventës, sipas vendimit të Dhomës së Madhe të sipërcituar, përbënte zbatim të plotë të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kërkuesi, nëpërmjet kërkesës për rishikim, pretendon se ndodhet në kushtet e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile.

3.5. Në përfundim, z. Arben Dollapaj kërkon rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 4 (JR), datë 12.03.2020.

Bashkëngjitur kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi ka bashkëngjitur si në vijim:

i) vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 4 (JR), datë 12.03.2020, të noterizuar njësia me origjinalin nr. {***} rep., datë 31.01.2023.

ii) material në gjuhën angleze (6 faqe) i Përfaqësuesve të Përhershëm të Islandës në Këshillin e Evropës drejtuar Departamentit për Ekzekutimin e Gjykimeve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

3.6. Lidhur me kërkesën e dytë, në Kolegji, më datë 20.04.2023, është paraqitur kërkesa tjetër për rishikim e vendimit nga kërkuesi Arben Dollapaj, e cila është protokolluar me nr. {***} prot., dhe regjistruar në Kolegji si çështja me nr. 51-40/2018 (JR). Nëpërmjet kësaj kërkesë, z. Arben Dollapaj pretendon se ish-gjyqtari L. D. ka qenë relator i çështjes në Kolegji, ndaj në zbatim të nenit 494 të Kodit të Procedurës civile është palë e interesuar dhe ka interes të ligjshëm për të paraqitur kërkesën për rishikim, pasi është gjykuar dhe shkarkuar nga një gjyqtar i emëruar në thyerje flagrante të legjislacionit të brendshëm dhe i cili është ndëshkuar penalisht me vendim penal të formës së prerë. Kërkuesi sqaron se pjesëmarrja e ish-gjyqtarit

L. D., ndërkohë që është dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë, është njëkohësisht në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

3.7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, më datë 21.03.2023, në dhomë këshillimi, ka marrë në shqyrtim çështjen penale me kërkues L. D. me objekt: “*Shfuqizimin e vendimeve nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. {***}, datë 26.10.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën [...]*”, dhe me vendimin nr. {***} ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”. Kërkuesi sqaron se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shpallur publikisht në datën 21.03.2023 vetëm dispozitivin e vendimit të tij, ndërsa arsyetimi nuk ishte bërë publik në këtë datë.

3.8. Sa më sipër, kërkuesi pretendon se plotësohen të gjitha kushtet për të bërë të mundur rishikimin e vendimit nr. 4, datë 12.03.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për shkak se në përbërje të trupit gjykues dhe relator i çështjes ka qenë një gjyqtar i ndëshkuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë, për veprën penale “*Falsifikim dokumentesh*”, gjë e cila përbën njëkohësisht edhe shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në komponentin “*gjykatë e krijuar me ligj*”. Këtë kërkesë, z. Dollapaj e mbështet në nenin 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile.

Bashkëngjitur kërkesës për rishikim, kërkuesi Arben Dollapaj ka dorëzuar në Kolegj vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Në seancën gjyqësore të datës 24.03.2026, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 448 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të bashkojë për gjykim me çështjen nr. 4-40/2018 (JR), datë 01.02.2023, edhe çështjen me nr. 51-40/2018 (JR), datë 20.04.2023, të kërkuesit Arben Dollapaj, me objekt rishikimin e vendimit (JR) nr. 4, datë 12.03.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 e Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: (a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

6. Në vijim të sa më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi dhe, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
7. Duke konfirmuar të njëjtën linjë arsyetimi, sikurse në vendimin e tij të mëparshëm, me nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y., trupi gjykues i Kolegjit rithekson edhe në këtë rast qëndrim, për sa i përket interpretimit të dispozitave të Kushtetutës, të nenit F të Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, kundrejt juridiksionit rishikues të vendimeve të formës së prerë në procesin e rivlerësimit kalimtar. Konkretisht, nga leximi harmonik i këtyre rregullimeve, trupi gjykues vëren se në to parashikohet në mënyrë të shprehur vetëm juridiksioni rivlerësues i Kolegjit, në funksion të kontrollit ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në ankimet e subjekteve të rivlerësimit apo ato të ushtruara nga Komisionerët Publikë. Gjithashtu, ka vlerësuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesave së parashtruara prej kërkuarit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016.
8. Trupi gjykues i Kolegjit, në vendimin e referuar më sipër, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. Sikurse analizuar në detaj në vendimin e sipërcituar të Kolegjit, është analizuar përse procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, i bën të pabazuara kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuari.
9. Nga leximi harmonik i dispozitës së nenit F, pika 8² e Aneksit të Kushtetutës dhe germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile³, një vendim i GjEDNj-së, që konstaton një shkelje të kryer në çështjen e një ankuesi konkret, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë

² Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³ “[...] Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur: [ë] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive.

10. Konkretisht, rrethanat që ligji parashikon se përbëjnë bazë për rishikimin e vendimeve, vlerësohet se nuk gjejnë zbatim në kontekstin e procesit të rivlerësimit të kërkuarit. Në kushtet që procesi i rivlerësimit është i jashtëzakonshëm, zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës, nga organe me mandat të kufizuar kohor, për shkak të objektivitetit dhe natyrës së tij *sui generis*, që rezulton edhe nga mënyra sesi është rregulluar në ligj, Kolegji do të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit përkatës, sipas germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, lexuar në harmoni me pikën 8 të Nenit F të Aneksit të Kushtetutës.
11. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në gjashtë germat e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.
12. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesave të paraqitura prej kërkuarit Arben Dollapaj, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim. Këto kërkesa nuk mund të shqyrtohen nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuari bën në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, sipas analizës së dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës⁴ së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
13. Në përfundim, kërkesat e paraqitura prej kërkuarit Arben Dollapaj nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksion rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë këto kërkesa konsiderohen nga trupi gjykues si të papranueshme. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm,

⁴ Vendimi nr.12, datë 19.04.2024, i Kolegjit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y.; Vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit A. B.; Vendimi nr. 10, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit B. M..

për t'u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.

14. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas arsytimit të mësipërm, sërish ato, dhe si *obiter dictum*, do të vlerësoheshin njësoj si të pabazuara edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor në Kolegj. Trupi gjykues vëren se GjEDNj-ja në çështjen *Cani kundër Shqipërisë* ka theksuar se procesi i rivlerësimit për kërkuesin [B. Cani] ka në fokus të drejtat dhe përgjegjësitë e tij si prokuror karriere dhe nuk kishte ndikim/implikime, të paktën jodirekte, mbi të drejtat e detyrimet e palëve të treta⁵. *Së fundmi*, dhe po aq me rëndësi, sikurse GjEDNj-ja ka theksuar, konstatimi i shkeljes së të drejtës për një “*gjykatë të krijuar me ligj*”, në rastin e çështjes së ngritur nga B. Cani dhe referuar më parë edhe në çështjen e *Ástráðsson*, nuk mund të konsiderohet vetvetiu një detyrim sipas Konventës, për t'i imponuar një shteti të paditur të rihapë të gjitha çështjet e ngjashme që janë bërë *res judicata* sipas ligjit të brendshëm, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se nuk gjen zbatim germa “ë” e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
15. Sa i përket ndikimit të veprës penale, për të cilën është deklaruar fajtor ish-gjyqtari L. D., në vendimin e Kolegjit për të cilin kërkohet rishikimi, trupi gjykues vlerëson se nuk rezulton që kërkuesi të ketë ngritur këtë pretendim gjatë procesit të tij të rivlerësimit e as të ketë pasur ndonjë pretendim lidhur me ish-gjyqtarin L. D., si ndikim negativ në cilësinë e “*gjykatës së krijuar me ligj*”. Për rrjedhojë, edhe duke abstraguuar nga mungesa e lidhjes shkakësore që nevojitet për zbatimin e germës “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, në kushtet që vepra penale referohet të jetë kryer vite përpara vendimit dhe nuk ka asnjë lidhje shkakësore me vendimin për të cilin kërkohet rishikimi, neni 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të argumentohet se gjen zbatim, elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera⁶.
16. Për sa më lart, trupi gjykues, arriti në përfundimin se kërkesat e paraqitura prej kërkuesit Arben Dollapaj nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, gjerat “c” dhe “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe, për pasojë, ato konsiderohen të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

⁵ Paragrafi 145: <https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-219773>.

⁶ Vendimet e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023 dhe nr. 4, datë 15.02.2024.

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesave të kërkuarit Arben Dollapaj, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 4, datë 12.03.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të regjistruara me: (i) nr. 4-40/2018 (JR), datë 01.02.2023; (ii) nr. 51-40/2018 (JR), datë 20.04.2023.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2026.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 61 datë 24.03.2026, për çështjen nr. 4-40/2018 regjistër (JR) datë 01.02.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuarit Arben Dollapaj, për rishikimin e vendimit nr. 4 (JR), datë 12.03.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislacionit në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuari A. Y.⁷.
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z. Arben Dollapaj, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafët 14 dhe 15 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁷ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-Artor-Ylli_perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, jam dakord me vendimin nr. 61 (JR), datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *“Mospranimin e kërkesave të kërkesit Arben Dollapaj, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 4, datë 12.03.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të regjistruar me: (i) nr. 4-40/2018 (JR), datë 01.02.2023; (ii) nr. 51-40/2018 (JR), datë 20.04.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”*, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, i bën të pabazuara kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuesi.
2. Nga shumica e trupit gjykues, në vendim, është përdorur e njëjta linjë arsyetimi si në çështjet e tjera që i përkasin kërkesave për rishikim të vendimeve të juridiksionit të rivlerësimit, se: *“[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”*.
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: *“Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”*.
4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t'i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesa e rishikimit ndaj vendimeve të tij nuk mund të pranohet. Në këto kushte, në vlerësim tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam kundër shumicës së trupit gjykues në vendimin nr. 61, datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Arben Dollapaj, për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 4 (JR), datë 12.03.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe kam ndarë mendim ndryshe sa i përket qëndrimit të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues⁸ të Kolegjit, për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ), sipas shkronjës “ë”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494⁹, shkronja “c”¹⁰ të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues, janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente ndër të tjera në mendimin e pakicës ndaj kërkesës së kërkuarit R. T.¹¹ si dhe mendimet paralele dhe qëndrimin e mbajtur prej meje në kërkesat për rishikim të paraqitura në çështje të tjera¹².
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNJ-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korrigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNJ.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNJ-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNJ-ja të shprehet me një vendim të

⁸ Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupit gjykues në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A.Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjykues.

⁹Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: [...] (c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; [...] (ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

¹⁰ Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarës R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

¹¹ Vendimi nr. 19, datë 08.05.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit R. T., për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 26 (JR), datë 21.10.2019.

¹² Vendimi nr. 9, datë 28.2.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit A. B. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 11 (JR), datë 03.07.2020; Vendimi nr. 18, datë 8.5.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit A. Gj. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 9 (JR), datë 26.6.2020, etj.

anëtari i trupit gjykues dhe as ekzistencën apo jo të lidhjes shkakësore për ndikim në dhënien e vendimit nga trupa gjyqësore.

5.5. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së dhe lexuar në harmoni me përmbajtjen e nenit 494/c të Kodit të Procedurës Civile, ekziston një detyrim që vendimet e marra nga një trup gjykues që nuk plotëson kërkesat e një gjykate “të krijuar me ligj”, duhet të rishikohen, për të siguruar që çdo padrejtësi e mundshme të korrigjohet. Ky pohim përbën një masë të nevojshme dhe merr një peshë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e reformës në drejtësi në Shqipëri, ku integriteti i procesit të *vetting*-ut, si një proces i jashtëzakonshëm e kalimtar, është thelbësor për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Në këtë linjë arsyetimi, edhe integriteti i trupit gjykues është thelbësor për besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Çdo shkelje e këtij integriteti si, dënimi penal i një gjyqtari, duhet trajtuar me seriozitet për të ruajtur besueshmërinë e procesit gjyqësor.

5.6. Kolegji i Posaçëm i Apelit, si organi kushtetues më i lartë dhe e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit kalimtar, si institucioni i pavarur që Kushtetuta¹⁸ i ka dhënë atributet e Gjykatës Kushtetuese¹⁹ dhe i ka përcaktuar një mision të qartë, si dhe që vendimmarrjet e tij t'i bazojë në parimet e procesit të rregullt, duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit, sipas parashikimeve të Konventës, Kushtetutës, ligjit të posaçëm²⁰ dhe ligjeve të aplikueshme, duhet të demonstrojë dhe të transmetojë siguri juridike dhe qartësi për ato aspekte të gjykimit që dhënia e drejtësisë i sjell për të zbatuar, sikurse është edhe mjeti i jashtëzakonshëm i rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

5.7. Dënimi penal i një anëtari të trupit gjykues, për arsye që nuk lidhen me vendimmarrjen e tij, por me kushtet për të qenë anëtar i këtij Kolegji, cenon standardin e integritetit gjyqësor dhe besueshmërinë e trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, pozitën vendimmarrëse të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paanshmërinë e tij, si dhe standardin e gjykatës së krijuar me ligj, të parashikuar dhe nga neni 6 i KEDNj-së. Në fund të fundit, vendimi penal i formës së prerë ndaj një anëtari të trupit gjykues që ka shqyrtuar ankimin e kërkuarit (në cilësinë e subjektit të rivlerësimit), ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit²¹, është një fakt i pakundërshtueshëm, i cili në një formë apo në një tjetër implikon sjelljen institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, integriteti institucional i të cilit duhet të mbrohet nëpërmjet zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, që e kanë sanksionuar atë.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

¹⁸ Neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

¹⁹ Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës parashikon se: “[...] Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje”.

²⁰ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”.

²¹ Vendimi nr. 63, datë 06.08.2018, i KPK-së për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj.